



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 916/3 Prot

Tiranë, më 5/8/2020

VENDIM

Nr. 36, datë 5 . 8 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 916 Prot., datë 21.07.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, nëpërmjet kërkesës së datës 04.07.2020, depozituar në adresën Anairda.Arizaj@drejtesia.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

1. *Kopje të kontratës me titull “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”.*
2. *A e konsideron Ministria e Drejtësisë këtë kontratë si “sekrete”?*
3. *Nëse po, cila është arsyeja.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankimin nr. 916 Prot., datë 21.07.2020 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 916/1 prot., datë 22.07.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Me e-mail-in datë 22.07.2020, koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik ka kthyer përgjigje duke informuar ankuesen ndër të tjerat se: “*Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor në mbështetje të VKM-së Nr.203, datë 26.02.2020 “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesat thelbësore të shtetit”, të Urdhërit nr. 100, datë 16.03.2020 “Për miratimin e rrethanave të gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit”, ka zhvilluar procedurën e prokurimit të drejtëpërdrejtë me objekt: “Blerje materiale mjekësore për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”, për nevoja dhe llogari të institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Kjo procedurë nuk është e klasifikuar. Vlera totale e kontratës është 48,207,800 (dyzet e tetë milion e dyqind e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh ose 57,849,360 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e dyzetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh. Dosja e kësaj procedure është e arshivuar në zyrën e arshivës së Ministrisë së Drejtësisë dhe Sektori i Prokurimeve nuk disponon asnjë dokumentacion të kësaj dosje.*”

Ankuesja, duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, ka vijuar ankimin me nr. 916/2 Prot., datë 24.07.2020, duke kërkuar “kopje të kontratës (përfshirë specifikimet teknike) si dhe përgjigjen e pyetjes nëse ky tender konsiderohet “sekret”.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në nenin 1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet qartë se, *objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike*. Në këtë kuptim, çdo autoritet, pavarësisht nëse është në cilësinë e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të

ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Nga shqyrtimi i përgjigjes datë 22.07.2020, konstatohet se, Autoriteti Publik ka informuar kërkuesen në lidhje me vlerën dhe materialet mjekësore objekt të kontratës, por nuk ka përmbushur detyrimin për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar, konkretisht: *Kopje të kontratës me titull "Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19"*, në kundërshtim kjo me pikën 1 të kërkesës për informacion datë 04.07.2020.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, duke qenë se dokumentacioni i sipërcituar administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi, këtë të fundit për koordinimin midis drejtorive dhe detyrimin e personave përgjegjës, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Autoriteti Publik vetëm në rastet kur konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ka detyrimin ta dërgojë atë pranë autoritetit kompetent duke vënë në dijeni edhe kërkuesen.

Lidhur me pikat 2 dhe 3 të kërkesës së sipërcituar, rezulton se Autoriteti Publik, ka informuar kërkuesen se kjo procedurë nuk është e klasifikuar, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin për informim në lidhje me këto kërkesa. Në këto kushte, pretendimi i ankueses se nuk është informuar nëse ky tender është "sekret", nuk qëndron.

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Si përfundim, në lidhje me ankesën e znj. _____, ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Drejtësisë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankesa duhet pranuar në mënyrë të pjesshme.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Autoriteti Publik në bërjen publike të dokumentit të kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*".

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “*autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj*”. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të tij*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 916 Prot., datë 21.07.2020 të znj. _____, ndaj Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 1 (*Kopje të kontratës me titull “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”*) të kërkesës për informacion datë 04.07.2020, brenda datës 12 . 8 .2020.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 04.07.2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 5 . 8 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

